



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010, për bashkëpunim ndërkomunal, nenit 5 të Rregullores nr. 09/2013, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal, dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019, merr këtë

V E N D I M PËR NISMËN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

I.

MIRATOHET Vendimi për nismën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës për bashkëpunim ndërkomunal.

II.

Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet në mes të Komunës së Vushtrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës, në lidhje me ndërtimin e rrugës Stanoc – Breznicë - Kozaricë – Barilevë - Lupç i Poshtëm.

III.

Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me komunat si në pikën II të këtij vendimi, për përgatitjen e propozimmarrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0073733/19, më 29.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta